




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-0/DPK</u> Nr. l faq. <u>02</u> Broj stranica Nr. pages	Nr. Prot. <u>01-1245/15</u> Prot. No Data <u>29.04.2015</u> Datum



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-503-15 për z.Ajnishahe Azemi – Këshilltare Komunale në Kuvendin e Prishtinës, dhe e zgjedhur Anëtare e Komisionit të Aksionarëve në Ndërmarrjen publike komunale “Termokos”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë situatën konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtarja e lartë, znj.Azemi, është e obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt “rast për rast” të interesit, të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur me kërkesën e palëve denoncuese nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-503-15, për Zyrtaren e lartë, znj. Ajnishahe Azemi – Këshilltare Komunale në Kuvendin e Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.Azemi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast, është njoftuar me pretendimet nga pala e tretë për situatë të dyshuar për konfliktit interesit, duke qenë se znj. Azemi në cilësinë e Këshilltares Komunale në KK të Prishtinës në Seancën e jashtëzakonshme të datës 14 janar 2015 dhe në Seancën e rregulltë të Kuvendit të datës 05 shkurt 2015, gjatë procesit të diskutimeve dhe votimit, pretendohet se ka pasur Konflikt interesi me Vendimet e marra në KK të Prishtinës.

Në takim me znj. Azemi, dhe në bazë të Ekstraktit të Procesverbalit nga Mbledhja e Kuvendit të Prishtinës, mbajtur me 05.02.2015 (DPK/DPKI-03-02-815/15) kemi vërtetuar se në atë Seancë së pari me Vendim që ka dal nga votimi në Kuvend, janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve. Ndërsa, pastaj po ashtu pas votimit, është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionareve të Ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Znj. Ajnishahe Azemi është propozuar dhe me votim është emëruar Anëtar i Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike komunale ngrohtorja e qytetit "Termokos".

Nuk qëndron pretendimi se gjatë kohës së diskutimit në Seancat e Kuvendit Komunal të Prishtinës lidhur me shkarkimin e Anëtarëve të Komisioneve Komunale të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike, djali i Ajnishahe Azemit – Ilir Azemi ka qenë Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Komunale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a.

Z. Ilir Azemi është shkarkuar nga kjo pozitë më 18 qershor të vitit 2014 dhe pikërisht si rezultat i këtij shkarkimi, ashtu siç e obligon ligji, me datën 18.07.2014 ai ka bërë Deklarimin e Pasurisë pas largimit nga funksioni (DLF04203/2014/1).

Ndërsa, pretendimi tjetër nga pala denoncuese se znj. Azemi ka konflikt interesi në zgjedhjen e saj për Anëtare të Komisionit të Aksionarëve për faktin se djali i saj është punonjës në "Termokos" nuk qëndron.

Nuk qëndron për arsye se të qenurit Anëtar i Komisionit të Aksionareve të Ndërmarrjes publike "Termokos" nuk ja mophon të drejtën djalit të saj për të vazhduar me punë në të njëjtën ndërmarrje, por as që e ndalon zgjedhjen e saj për shkak se ka konflikt interesi me këtë punë.

Kjo lidhje, eventualisht mund të sjell konflikt "rast për rast" të interesit në të ardhmen. Por, atëherë në situata të tilla, zyrtarja e lartë, znj. Ajnishahe Azemi duhet që ta deklarojë atë dhe të tërhiqet nga vendimmarrja e tillë që do të bëhej shkak për lindjen e një konflikti të interesit (Neni 13, paragrafi 1, 2, 3).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

